



D-FINITY ACCOUNTING PRO

Sistem Kontabël · V1.0

Pasqyrat financiare në këtë version janë sipas SKK 15 për mikronjësitë.

Manual i Përdorimit Versioni Demo Falas — 20 Veprime

FREE DEMO · 20 VEPRIME KONTABËL

1. Si funksionon D-Finity — logjika në thelb

D-Finity është një motor kontabël me dy-anësi (double-entry) — çdo lek që hyn diku, del nga diku tjetër. E ushqeni sistemin me një burim të vetëm të së vërtetës: **Ditari**. Gjithçka tjetër — Libri i Madh, Bilanci i Provës, PASH, Bilanci — janë pasqyrime automatike të asaj që gjendet në Ditar.

Rregulli i artë: nëse diçka duket gabim në një raport, mos e “rregulloni” atje — kthehuni te Ditari dhe gjeni veprimin që e shkaktoi.

Zinxhiri i automatizmit

Hapi	Çfarë ndodh	Sheet
1	Regjistroni një veprim (data, kodi i llogarisë, Debit ose Kredit)	DITARI
2	Sistemi e njeh automatikisht llogarinë dhe kontrollon Debi = Kredi	DITARI (kolona Status)
3	Libri i Madh grupon çdo veprim sipas kodit të llogarisë, format “T”	LIBRI_I_MADH
4	Bilanci i Provës mbledh çdo llogari, kontrollon Debi = Kredi	BILANCI_PROVE
5	PASH llogarit rezultatin e vitit sipas natyrës së shpenzimeve	PASH_MIKRO_FINAL
6	Bilanci tregon gjendjen: Aktive = Detyrime + Kapital	BILANCI_MIKRO_FINAL

2. Fillimi i shpejtë (2 minuta)

- Hapni **FILLONI_KETU** — kjo është faqja kryesore.
- Klikoni **Cilësimet** dhe plotësoni: emrin e biznesit, NIPT, vitin fiskal, monedhën.
- Regjistroni veprimin në **DITARI**, duke përdorur të njëjtën ID për të gjitha rreshtat Debit/Kredit të të njëjtit veprim.
- Klikoni **Paneli Kryesor** (Dashboard) — shihni gjendjen e përgjithshme.

Shembull — regjistrimi i veprimit të parë: Në DITARI, rreshti i parë bosh: Data = 01/01/2025, ID Veprimi = JV-0001, Kodi Llogarie = 512 (Bankë), Debit = 500.000. Rreshti tjetër: e njëjta ID JV-0001, Kodi = 101 (Kapitali), Kredit = 500.000. Kaq — ky është regjistrimi i kapitalit fillestar të biznesit, i bërë me **një veprim të vetëm** në dy rreshta.

3. Numëruesi i Demos — si numërohen 20 veprimet

Versioni Demo ju lejon të regjistroni deri në **20 veprime kontabël**, plotësisht falas. Një **veprim** identifikohet nga **ID Veprimi** (kolona C në DITARI), jo nga numri i rreshtave.

Shembull: ID JV-0001 mund të përdoret në dy, tre ose më shumë rreshta (p.sh. Debit në një rresht, Kredit në tjetrin) — të gjithë këta rreshta së bashku numërohen si **vetëm NJË veprim**. Veprimi tjetër përdor një ID të re, p.sh. JV-0002.

Në krye të fletës **DITARI** gjendet një panel i vogël që tregon gjithmonë:

- VEPRIME TË PËRDORURA: X / 20**
- VEPRIME TË MBETURA: 20 – X**

Pranë tyre shfaqet një status me ngjyrë:

Veprime të përdorura	Statusi
0 – 15	DEMO AKTIVE
16 – 19	PO I AFROHENI KUFIRIT
20	KUFIRI DEMO U ARRIT
mbi 20	KUFIRI DEMO U TEJKALUA

ID-ja e 21-të refuzohet automatikisht. Kur të tentoni të krijoni një ID të re përtej 20 veprimeve, D-Finity shfaq një mesazh ndalues: „D-FINITY DEMO – KUFIRI U ARRIT. Keni përdorur 20 veprimet e versionit Demo. Për të vazhduar punën, kërkon versionin e plotë të D-Finity Accounting Pro.” Përsëritja e një ID-je ekzistuese (p.sh. për të plotësuar rreshtin Kredit të një veprimi tashmë të hapur) vazhdon të lejohet gjithmonë, pavarësisht kufirit.

4. Veprimet Rregulluese dhe Mbyllja e Vitit

Gjatë vitit, disa fakte ekonomike (amortizimi, tatimi mbi fitimin, parapagimet) nuk regjistrohen si transaksione të dukshme. D-Finity i llogarit vetë në fletën **VEPRIMET_RREGULLUESE** — ju vetëm shqyrtoni dhe konfirmoni.

Në fund të vitit, llogaritë e klasave 6 (shpenzime) dhe 7 (të ardhura) mbyllen drejt llogarisë 121 (Rezultati i Ushtrimit) nëpërmjet fletës **MBYLLJA_6_7_AUTO**: shihni rezultatin e parallogaritur, konfirmoni në qelizën B8, dhe veprimet e mbylljes shfaqen vetë në Ditar — pa asnjë copy-paste.

Mos e ktheni konfirmimin në “JO” pasi ta keni mbyllur vitin — kjo fshin veprimet e postuara nga Ditari. Për korrigjim pas mbylljes, shtoni një veprim të RI.

5. Kur t'i mbaroni 20 veprimet

Kur numëruesi tregon **20 / 20** dhe bindeni që D-Finity përshtatet me punën tuaj, kërkon versionin e plotë:

- Në fletën **FILLONI_KETU**, klikoni butonin gold **“KËRKO VERSIONIN E PLOTË”**.
- Ose në fletën **DITARI**, pranë numëruesit, i njëjti buton.

Butoni hap një email të para-plotësuar drejt **info.dfinity@gmail.com**, gati për t'u dërguar.

4.900 lekë — për 10 licencat e para

Më pas: 9.900 lekë — pagesë një herë, pa abonim mujor.

Email: info.dfinity@gmail.com · Instagram: [@dfinity.accounting](https://www.instagram.com/dfinity.accounting)